

Rabije Murati, PhD¹

UDC: 37.018.1:316.812.1-055.52

FAMILJA, FAKTOR I EDUKIMIT

СЕМЕЈСТВОТО, ФАКТОР НА ОБРАЗОВАНИЕТО

THE FAMILY, A FACTOR IN EDUCATION

Abstract

All parents want to have educated children, but not everyone knows and recognizes the secret of proper education. This means that from birth until the child's full maturity, parents should not forget their obligation to their children and do something illogical and thoughtless by saying that "everything will be fixed by itself in time. It is much easier for a child to be educated in time and in a fair and normal way, than to be re-educated later.

The problem of educating the individual is evident especially in the last years of the 20th century, where even from many researchers of educational practice we have different findings that in today's contemporary school we have an oversight and a neglect of the educational function of the school in favor of its educational function.

Abstract

The family is a part of social change and, as such, evolves and transforms in step with contemporary trends shaped by society. The function of the family in a given society is structured depending on the general changes that occur in all areas of social life, including family life itself. Contemporary conditions impose significant demands that must be met in order to keep pace with the times. Particularly noteworthy are the social changes related to the rise and advancement of educational and professional standards, which consequently increase the overall impact on the family and its functions.

¹ Fakulteti Pedagogjik, Universiteti i Tetovës
Email: rabije.murati@unite.edu.mk

If we aim to ensure full parental responsibility in the upbringing of children, it is essential to consider the conditions in which the family lives. For a proper and fair upbringing of children, the size of the family (i.e., the number of its members) is of special importance. With the tendency that the higher the economic standard, the fewer the number of children in a family, it is evident that smaller families or those with fewer members provide greater opportunities for parents to dedicate more time and care to their children.

One of the inherent roles of the family, regardless of whether it is located in an urban or rural area, in developed or underdeveloped regions, is the participation, mediation, and transmission of moral, social, and other values in contemporary life.

Keywords: *family, family education, family function, child upbringing.*

Hyrje

Të gjithë prindërit dëshirojnë që të kenë fëmijë të edukuar, por jo të gjithë e dinë dhe e njohin fshehtësinë e edukimit të drejtë. Kjo d.t.th. se që nga lindja e deri në mëvetësimin e plotë të fëmijës, prindërit nuk duhet të harrojnë obligimin e tyre që e kanë ndaj fëmijëve dhe të bëjnë diçka të palogjikshme dhe të pamenduar duke thënë se "çdo gjë do të rregullohet vetvetiu me kohë". Shumë më lehtë fëmija do të edukohet me kohë e në mënyrë të drejtë dhe normale, se sa më vonë të riedukohet.

Problemi i edukimit të individit është evident sidomos viteve të fundit të shekullit XX ku edhe nga studiues të shumtë të praktikës edukative kemi konstatime të ndryshme se në shkollën e sotme bashkëkohore kemi një anashkalim dhe një lënie pas dore të funksionit edukativ të shkollës në favor të funksionit arsimor të saj.

Zhvillimi historik i familjes dhe edukimit familjar

Mendimet pedagogjike për edukimin familjar janë ngritur në suazat e filozofisë si edhe mendimet pedagogjike në përgjithësi, kështu që është shumë e arsyeshme që do të cek mendimet e filozofëve më të njohur në antikë. Është e njohur që Platoni dhe Aristoteli kanë dhënë kontribut më të dalluar dhe mendime më të rëndësishme për edukimin familjar dhe përgatitjen e të rinjve për jetë familjare. Platoni ka theksuar se për jetë bashkëshortore të suksesshme është më e rëndësishme që të harmonizohen karakteret e bashkëshortëve të ardhshëm.

Aristoteli nga ana tjetër thekson funksionin e trefishtë të ekonomisë shtëpiake, që janë: funksioni ekonomik, martesor dhe prindëror. Funksionin martesor dhe atë familjar i ka konsideruar si primar dhe thekson se, në ekonominë shtëpiake të preferuara kujdes apo vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet njerëzve, se sa të arriturave të kapitalit të palëvizshëm.

Mishel Montenj përqendrohet në atë që të mund të organizohet jeta familjare ashtu që çiftet e reja bashkëshortore të mund të jetojnë edhe ndaras edhe së bashku me prindërit e tyre, ashtu që të rinjtë do të mësoheshin nga më të vjetrit kurse më të vjetrit do të kënaqeshin në atmosferën e lumtur me nipërit e tyre.

Në mësimet pedagogjike ka pasur edhe tendenca për familjarizim të shkollës. Ajo ka qenë një tendencë me qëllim të mirë që të mundet jeta familjare dhe mënyra e edukimit të fëmijëve të transmetohet në institucionet arsimore. Nga kjo rrjedh edhe qëndrimi që raporti në mes arsimtarit dhe nxënësit në shkollë duhet të jetë raport prindëror. Por ka edhe tendenca të atilla të shkollarizimit të familjes, ku fëmijët në familje do të përgatiten për nisje në shkollë.

Ajo që e karakterizon shumicën e pedagogëve është kuptimi që çdo marrëdhënie në familje njëherit është edhe marrëdhënie pedagogjike. Për këtë arsye nga prindërit më shpesh kërkohet që ndaj fëmijëve të kenë qëndrim të drejtë pedagogjik, që do të thotë se nuk duhet të teprojnë me ashpërsinë e tyre por as edhe të jenë tepër tolerantë në kërkesat e tyre, por ata duhet me një dozë rezerve çdoherë e më tepër t'i kyçin fëmijët e tyre në jetë.

Përfaqësuesi më i njohur i edukimit individual Zhan Zhak Ruso ka kërkuar që fëmijët të edukohen jashtë familjes, nën mbikëqyrjen e arsimtarit. Ruso në diskutimet e tija teorike e ka theksuar rëndësinë e familjes në një mënyrë shumë subtile. Dashuria e prindërve mund të jetë si një shpatë me dy tehe. Mungesa e saj por edhe doza e tepërt e saj mund të kenë pasoja të rënda për fëmijën.

Familja është lëndë e studimit e shumë shkencave. Kështu N.V.Ekerman familjen e thekson si institucion i vjetër sa edhe njerëzimi, mikrokozmos i vogël dinamik dhe i ndryshueshëm si edhe vetë shoqëria. Për këtë arsye edhe trajtimi dhe shqyrtim i saj është nevojë e rëndësishme shoqërore (Ekerman, N.V., f.15).

Për definimin e familjes ekzistojnë trajtime dhe përkufizime të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Në vijim do të mundohem që të theksoj disa nga ata. Kështu autori L.Mann familjen e konsideron si grup të vogël social në të cilën ekzistojnë marrëdhënie natyrore mes anëtarëve të saj (Mann, L., f. 26). Nga ana tjetër D.Saviqeviq thekson se martesë dhe familja janë grup mikrosocial (Saviqeviq, D., f. 35). Kurse autori M. Mladenoviq thekson se familja nga struktura e përbajtjes dhe nga kushtet formale është grup shoqëror historikisht i ndryshueshëm. Sipas tij familja mund të definohet edhe si bashkësi e njerëzve të lidhur me martesë apo farefisni (Mladenoviq, M., f. 26).

Morgan potencon se familja është element aktiv i cili asnjëherë nuk qëndron në vend, por çdoherë shkon para duke u nisur nga shkalla më e ulët e deri në shkallën më të lartë (Morgan, B., f.13). Autori D. Jezernik shpjegon se familja është grupi i parë të cilit çdo individ njerëzor i takon (Jezernik, D., f. 126).

Në definimin e familjes në të shumtën e rasteve gabohet kurë ajo barazohet me nocionet martesë dhe ekonomi shtëpiake (amvisëri). Edhe përkundrejt asaj se mes tyre ekziston një ngjashmëri, përsëri ata mes vete dallohen ashtu që çdo njëra

nga ata kanë kuptim apo domethënie të veçantë. Kështu martesë sipas autorit Mladenović definohet kështu: “Martesë është lidhje shoqërore e natyrshme-gjinore, sipas rregullave natyrore e përhershme, në mes të njerëzve të gjinive të ndryshme, e cila varësisht nga kushtet historike dhe shoqërore mund të ketë edhe forma të ndryshme (si martesë qytetare, kishtarë, joformale, faktike) dhe përmbajtje dhe detyra të ndryshme (si ekonomike, ligjore, sociale, shpirtërore, morale, psikike, estetike, etj.) (Mladenović, M. f.30).

Sa i përket çështjes së dallimit të familjes dhe amvisërisë (ekonomisë shtëpiake), mund të konstatojmë se ekonomi shtëpiake paraqet çdo familje apo bashkësi njerëzore, anëtarët e të cilit jetojnë së bashku dhe bashkërisht i harxhojnë të ardhurat e tyre. Amvisëritë mund të jenë të përbërjeve të ndryshme si: ekonomi shtëpiake të vetmuara të cilat i përbëjnë individë; familje të kuptimit më të ngushtë, të përbëra nga prindërit dhe fëmijët; familje në kuptim më të gjerë në të cilat përveç prindërve dhe fëmijëve ekzistojnë edhe nipërit dhe mbesat, vëllezër, motra dhe bashkëshortët e tyre; ekonomi shtëpiake që nuk kanë lidhje farefisnore, në të cilat bëjnë pjesë të gjitha ekonomitë shtëpiake të tjera në të cilat anëtarët jetojnë së bashku.

Familja dhe ekonomia shtëpiake në esencë kanë disa karakteristika specifike që i karakterizojnë ata. Kështu me të drejtë mund të themi se anëtarët e familjes janë në mënyrë biologjike të lidhur mes veti më shumë se çdo grup tjetër, e para së gjithash prindërit dhe fëmijët, gjithashtu edhe burri dhe gruaja si partnerë seksual të cilët plotësohen njëri me tjetrin.

Në lidhje me këta karakteristika specifike autori Z. Dolenc shprehet kështu: “Në radhë të parë në familje duhet të ekzistojnë dashuri si forcë themelore e cila ka fuqi të bashkimit dhe ndarjes të anëtarëve të bashkësisë familjare” (Dolenc, Z., f.88).

Karakteristikë tjetër e jetës familjare është tendenca kah konservativizmi në familje i cili shprehet me përpjekjet që të rruhen vlerat dhe raportet tradicionale në familje dhe jeta të organizohet sipas shembullit të prindërve të vet.

Me paraqitjen e prodhimit industrial paraqitet edhe “kriza” në familjen patriarkale, kur edhe paraqiten kushtet dhe kërkesat që anëtarët e familjes të punojnë jashtë saj.

Vlen të përmendim edhe ndryshimet në marrëdhëniet në mes të burrit dhe gruas në familje, ku gruaja inkadrohet në sferën e punës jashtë familjes dhe shtëpisë.

Familja bashkëkohore që mund të shprehet edhe me termin familje demokrate, tregon tendencat kah ndryshimet e rëndësishme edhe në raport me stilet e udhëheqjes së familjes. Demokratizimi i marrëdhënieve në mes të burrit dhe gruas e kushtëzoi edhe demokratizimin e marrëdhënieve në mes të prindërve dhe fëmijëve.

Hulumtimet bashkëkohore tregojnë rëndësinë e marrëdhënieve që formohen në mes vetë fëmijëve në familje.

Struktura e familjes

Mikroanaliza dhe struktura e brendshme e organizimit familjar e përfshin: përbërjen e familjes, ndarjen e punëve dhe detyrat e punës në familje, kështu e zhvillon distribuimin e roleve, autoritetit, strukturën e raporteve reciproke dhe sistem të vlerave të miratuara dhe normave të sjelljes.

Ekzistojnë më shumë ndarje të strukturës së familjes të cilat mund të formulohen në më shumë nivele, kështu mund të dallojmë:

1. Niveli më i përgjithësuar i ndarjes është sipas strukturës klasore të shoqërisë, kjo do të thotë se në kushte të ndryshme shoqërore klasat janë të përcaktuara në mënyra të ndryshme;

2. Ndarja e dytë apo ndarja sekondare është sipas strukturës profesionale që në fakt paraqet klasifikim (ndarje) të kualifikimit paraprak, në të cilin përkohet: familjet e ekspertëve, zyrtarëve administrativë, punëtorët industrial, etj.;

3. Niveli i tretë i ndarjes është sipas korrelacionit qytet-fshat, ku bëhet ndarja e familjeve në ata qytetare dhe fshatare.

Strukturën e familjes e përbëjnë:

a) *përmbajtja (tërësia) e brendshme; dhe*

b) *elementet nga organizimi i grupit familjar* - mikroanaliza përfshin: përbërjen e familjes, ndarjen e punës dhe detyrave të punës në familje, në bazë të kësaj e zhvillon ndarjen e roleve, autoritetit, relacionit të ndërsjellë.

Struktura familjare mund të klasifikohet në disa nivele edhe atë:

1. Niveli i përgjithshëm sipas strukturës klasore të shoqërisë;
2. Sipas strukturës profesionale;
3. Sipas lokacionit apo vendit ku ndodhet familja (qytet-fshat).

Për zhvillimin e personalitetit të individit varet se a është ai fëmija i parë i familjes apo i fundit, a zhvillohet dhe rritet ai në familje me fëmijë të gjinisë së njëjtë apo të ndryshme, etj.

Suksesi i edukimit në radhë të parë varet nga interaksionet subtile që si zakonisht vendosen nëpërmjet lidhjeve komunikative në mes të subjekteve që marrin pjesë në edukim.

Pra, element kyç në suksesin e edukimit është marrëdhënia e suksesshme në mes të edukuesit dhe të edukuarit.

Sjellja ekstreme parimore në marrëdhëniet prind - fëmijë është ajo kur prindi merr pozicionin autoritar në familje dhe e ngulfat çdo iniciativë të fëmijës dhe të riut.

Sjellja e dytë ekstreme është më tepër prezente në mjediset qytetare kur nën moton e prindit bashkëkohor, prindërit i plotësojnë të gjitha kërkesat dhe dëshirat e fëmijëve të vet.

Karakteristikë e reciprocitetit në marrëdhëniet në familje është mundësia e konfrontimeve të mendimeve, që d.t.th. gatishmëri e prindit të pranon gabimin dhe se në momente dhe raste të veçanta fëmija apo adoleshenti ka të drejtë.

Karakteristikë më relevante e reciprocitetit është themelimi i dialogut. Ajo është forma më humane e komunikimit në mes njerëzve. Pa dialog nuk mund të ketë komunikim të suksesshëm edukativ.

Në suaza të kësaj që deri më tani elaborova vlen të përmendi se si autori Tihomir Prodanoviq shprehet për procesin apo mënyrën e suksesshme të edukimit nga ana e prindërve, i cili thotë: “Me sukses mund të edukojë vetëm ai prind që është i përgatitur në mënyrë sistematike për punë edukative i cili me përgjegjësi të plotë e pranon qëndrimin se edukimi është proces i përvetshëm”.

Më tutje, duke u bazuar në strukturën farefisnore mund të dallojmë:

- **Familje nukleare**
- **Familje të zgjeruar**

Gjatë analizës së elementeve të strukturës së familjes duhet të merret parasysh edhe cikli jetësor i familjes, që i thekson fazat e themelimit dhe kohëzgjatjes së grupit familjar.

Fazat e ciklit jetësor të familjes i paraqesim kështu:

- **Cikli paramartesor apo faza e parë martesore** - që përfshin periudhën para martesore deri katër vite martesë si çift i rri martesor pa fëmijë;
- **Faza e dytë është faza prindërore** - që përfshin fazën parashkollore të fëmijës, atë shkollorë dhe adoleshencën;
- **Fazën pasprindërore** – e cila fillon me martesën e fëmijëve dhe fazën e gjyshit apo gjyshes, dhe
- **Faza e të qenit i/e ve apo faza e martesës së sërishme.**

Funksioni themelor i familjes bashkëkohore

Funksionet familjare nuk janë fenomen statik por ata ndryshojnë me zhvillimet dhe ndryshimet në shoqëri. Sipas autorit M.Mladenoviq theksohen disa funksione të familjes bashkëkohore, siç janë:

- Funksioni biologjiko-reproduktiv;
- Funksioni biologjik-gjinor dhe emocional;
- Funksioni ekonomik;
- Funksioni moral dhe edukativ, dhe
- Funksioni mbrojtës.

Familja është institucion i cili është i vjetër aq sa edhe vetë njerëzimi dhe ajo paraqet një dukuri paradoksale dhe të paprekshme. Për këtë arsye, është shumë e natyrshme që të pranojmë rolin e saj në jetën tone. Edhe pse

qysh me mijëra vite më herët njerëzit kanë pasur kohë që të mësohen dhe të adaptohen me familjen, përsëri çdo gjeneratë patjetër duhet të mësohet si të mëson dhe të jeton në familje.

M.Mladenović thekson se funksioni moral dhe ai edukativ janë në një lidhje të pandashme dhe ofrojnë mundësi për mbijetesë të familjes. Këta dy funksione bëhen baza racionale e cila e dëshmon qëllimin për ekzistimin dhe mbijetesën e familjes si institucion.

Pasi do të përcaktohen qëllimet e edukimit, procesi edukativ do të mundëson ndërtim të plotë të personalitetit. Familja bashkëkohore paraqitet si ndërmjetësues i gjithçka që ekziston në shoqërinë e dhënë si “normale” dhe të asaj që trajtohet si “jonormale”. Prandaj mendohet se familja është qendra ku takohet shoqërorja dhe individualja dhe në të cilën ata duhet të përputhen. Familja është ndërmjetësues në mes sistemit shoqëror dhe kulturës shoqërore, për arsye se personi i formuar mire, me sukses e realizon procesin e riprodhimit me të gjitha potencialet e tij.

Conclusion

In contemporary society, special attention should be paid to the creation of human resources, because they will be the power of human change and prosperity.

Not only teachers but also parents face the issue of education every day. That is why we say that education is the pillar of humanity, the foundation for a more harmonious and developed society.

Education and upbringing are the pillars of healthy and well-formed humanity.

Education is a long and complex process, which requires continuous approach and commitment to succeed.

Education is a factor and condition of the human process of humanity, the humanization of society and at the same time their consequence. There is no human community without education, nor without education outside the human community. Man needs to change himself and the environment in which he lives, and he makes this change consciously, so that by changing himself, others and the environment in which he lives and creates, he also achieves individual perfection, and all this man can achieve through the fundamental process - EDUCATION.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Dolenc, Z., (1970), Porodica i socijalizacija mladih, Kultura, Beograd
2. Ekermen, N.V., (1960) Psihodinamika porodicnog zivota, Graficki zavod, Titograd

3. Mann, L.,(1973) Social Osychology, Sideny
4. Mladenovic, M., (1977), Osnovi sociologije porodice, Savremena administracija, Beograd
5. Morgan, B., (1960), The methods of adult education, Ilionios
6. Savicevic, D., (1975), Teorijsko-metodoloski problemi komparativnog proucavnja vaspitanja i obrazovanja, Zbornik 8, Institut za pedagogoska istrazivanja, Beograd
7. Savicevic, D., (1967), Obrazovanje za zivot u porodici, Zavod za izdavanje udzbenika, Beograd
8. Jezernik, D., (1972), Grupa i grupna dinamika, Socijalna psihologija, Beograd